



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË SH.A

Nr. _____, Prot.

Vlorë, më _____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje karburanti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0 – Karburante

VLERA E FONDIT LIMIT:

19,588,975(nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind shtatëdhjetë e pesë)
Lekë pa TVSH ose **210,476** (dyqind e dhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) **Euro pa Tvsh.**
(Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 10.08.2026, 1 euro = 93.07 All)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujës-jellës Kanalizime Vlore sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas kriterëve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se:

"Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit", si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji", si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri, paraqitja e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2023,2024,2025, vlera e xhiros minimale vjetore duhet të jete jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës".

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë informacion mbi xhiron vjetore për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar. Përcaktimi i kërkesës për xhiron vjetore është bërë në përpjesëtim me vlerën e fondit limit dhe natyrën e kontratës, me qëllim garantimin që operatorët ekonomikë disponojnë kapacitet të mjaftueshëm financiar për realizimin e kontratës. Gjithashtu, kjo kërkesë është në përputhje me

legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me Ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të cilat përcaktojnë detyrimin e tatimpaguesve për deklarimin e të ardhurave dhe dokumentimin e aktivitetit ekonomik. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të sigurohet që operatorët ekonomikë kanë stabilitet financiar dhe aftësi për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga kontrata, duke garantuar realizimin e saj me sukses.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2026** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar duke pasur ne vemendje parashikimet e ligjit 9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, I ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njësitë e vetqeverisjes vendore), per të gjitha pikat e ushtrimit te veprimtarise sipas QKB.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin e fundit sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët, për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga ISHTI për analizën e karburantit .Operatori duhet te paraqese analizat per gazoilin dhe benzinen te leshuara brenda tre muajve te fundit !

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6, gërma c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, ligjin nr.10 433, datë 16.6.2011, Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse, Urdhërit nr 315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”. Plotësimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij periodik zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi. (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik për realizimin e procedurës objekt prokurimi duhet të disponojë me pakten një pikë karburanti në pronësi ose me qira brenda territorit të Bashkisë Vlorë.

- Për pikat e karburantit në pronësi, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që provon disponimin e tyre. Për pikat e karburantit të marra me qira ose në përdorim, duhet të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë/përdorimit, e lidhur sipas legjislacionit në fuqi dhe e noterizuar. Në rastet e marrëveshjeve të shfrytëzimit, duhet të paraqitet dokumentacioni që provon të drejtën e përdorimit të pikës së karburantit gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se furnizimi i mjeteve do të jetë e mundur të realizohet çdo ditë të javës brenda 24 orëve në të gjithë distributorët e furnizuesit dhe në pistoletë publike. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme.**(Deklarate me shkrim nga subjekti ofertues)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma ç,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte kerkuar qe operatori ekonomik te vetdeklaroje deklarimet e mesiperme pasi AK kerkon garanci qe furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas VKM Nr 561 date 29.07.2016“Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“,Kartat do kene vlefshmeri deri ne mbarimin e plote te sasise se Karburantit të prokuruar furnizimi me karburant do behet ne cdo kohe me pistolete publike dhe sherbim 24 ore

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën për tregtim karburantesh/ lëndë djegëse, të kategorise II/A dhe III/A, lëshuar nga Autoriteti Vendor ku ushtron veprimtarine.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor mund të kërkojë dokumente që vërtetojnë përshtatshmërinë për të ushtruar veprimtarinë profesionale. Duke qenë se objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me furnizimin me karburant, operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e këtij aktiviteti sipas legjislacionit sektorial në fuqi. Kjo kërkesë është e domosdoshme për të garantuar që kontrata do të realizohet nga një subjekt që ushtron ligjërisht aktivitetin e tregtimit të karburanteve dhe është në përpjesëtim të drejtë me objektin dhe vlerën e kontratës..

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete I pajisur me Leje Mjedisit tipi B e leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Aktiviteti i tregtimit dhe depozitimit të karburanteve është një veprimtari që mund të ketë ndikim në mjedis dhe për këtë arsye ushtrohet vetëm nga subjekte të pajisura me lejet përkatëse mjedisore. Kërkesa për paraqitjen e Lejes së Mjedisit Tipi B garanton se operatori ekonomik ushtron aktivitetin në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore të miratuara, duke minimizuar rreziqet që lidhen me ndotjen e mjedisit dhe duke garantuar realizimin e kontratës në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe nuk tejkalon atë që është e nevojshme për realizimin e kontratës.

2.3.6 Operatori ofertues duhet të disponojë Vërtetim Teknik “Per respektimin e normave dhe kushteve teknike ne stacionet e tregtimit te karburanteve”,te leshuar nga organet e miratuara qe verteton se subjekti qe tregon karburante permbush kushtet teknike te miratuara dhe ka respektuar normat e tregtimit te karburanteve

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me qëllim verifikimin e aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës. Vërtetimi teknik provon se stacionet e tregtimit të karburanteve përmbushin normat dhe kushtet teknike të miratuara nga legjislacioni në fuqi, duke garantuar sigurinë e furnizimit, cilësinë e shërbimit dhe respektimin e standardeve teknike të kërkuara. Duke qenë se furnizimi me karburant do të kryhet nëpërmjet pikave të tregtimit të operatorit ekonomik, është e nevojshme që këto pika të jenë të certifikuara dhe të autorizuar për ushtrimin e aktivitetit, në mënyrë që të garantohet një furnizim i sigurt dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

2.3.7 Në mbështetje të V.K.M-së Nr.561, datë 29.07.2016 “Për standardizimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “furnizimi me karburant për automjetet duhet të kryhet nëpërmjet **kartës elektronike**, e cila të mundësojë identifikimin e mjetit dhe përdoruesin e tij. Kartat elektronike duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës dhe të mundësojnë furnizimin pa ndërprerje deri në përfundimin e saj.

***Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të V.K.M. nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standardizimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, e cila parashikon përdorimin e kartave elektronike për administrimin dhe kontrollin e konsumit të karburantit. Përdorimi i kartave elektronike garanton identifikimin e automjeteve dhe përdoruesve përkatës, monitorimin e sasisë së furnizuar, kontrollin e shpenzimeve dhe gjurmueshmërinë e plotë të transaksioneve. Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe synon përdorimin me efektivitet, ekonomi dhe transparencë të fondeve publike, në përputhje me parimet bazë të prokurimit publik të përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Për këtë arsye, kartat elektronike duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës dhe të sigurojnë furnizim të pandërprerë sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

➤ **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Specifikimet teknike dhe termat e references janë hartuar nga specialist i fushës, i cili ka njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.

*Shënim: Specifikimet teknike dhe termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe standardeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur

në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

➤ **SQARIM NË LIDHJE ME MOSNDARJEN E PROCEDURËS NË LOTE:**

Në Kreun V, Nenin 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor, kur është e mundur, duhet të marrë në konsideratë ndarjen e kontratës në lote, duke argumentuar në dokumentet e tenderit rastet kur një ndarje e tillë nuk është realizuar.

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se procedura me objekt **“Blerje Karburanti”** nuk duhet të ndahet në lote, pasi objekti i prokurimit përbën një furnizim të unifikuar dhe të pandashëm, i cili kërkon administrim dhe zbatim të njëtrajtshëm gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Ndarja në lote nuk do të sillte përfitime ekonomike apo teknike për autoritetin kontraktor, pasi produktet e kërkuara janë të së njëjtës natyrë dhe përdoren për të njëjtin qëllim, duke garantuar funksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a. Përkundrazi, një ndarje e tillë do të sillte vështirësi në administrimin e kontratës, monitorimin e furnizimeve, menaxhimin e kartave elektronike të karburantit dhe koordinimin me disa operatorë ekonomikë njëkohësisht.

Gjithashtu, realizimi i furnizimit nga një operator i vetëm ekonomik siguron standardizim të kushteve të furnizimit, unifikim të çmimeve dhe procedurave të administrimit, si dhe garanton vazhdimësinë e pandërprerë të furnizimit me karburant për automjetet dhe pajisjet e autoritetit kontraktor, të cilat janë të domosdoshme për ofrimin e shërbimit publik të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se mosndarja e procedurës në lote është e justifikuar, e arsyeshme dhe në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, duke garantuar përdorimin me efektivitet të fondeve publike dhe realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e Prokurimit